

**Shkresë e Departamentit të Shëndetësisë:
Kontrolli i vaksinimit të fëmijëve të klasave të gjashta**

Të nderuar prindër,

siç e dini tashmë, kontrolli i plotë i vaksinimit sipas moshës është i rëndësishëm për të qenë sa më të mbrojtur nga sëmundjet e rënda si tetanosi, difteria ose fruthi. Duke qenë se rekomandimet e vaksinimit ndryshojnë vazhdimisht, për fëmijët dhe prindërit është shpesh e vështirë të identifikojnë boshllëqet e vaksinimit. Ndonjëherë karta e vaksinimit na humbet nga vëmendja në përditshmëri. Në emër të Ministrisë Bavareze të Shëndetësisë, Departamentet Bavareze të Shëndetësisë u ofrojnë nxënësve të klasave të gjashta një kontroll të anonimizuar të kartave të tyre të vaksinimit. Çdo fëmijë merr më pas një përgjigje me shkrim me rekomandimet individuale lidhur me vaksinimet që duhet të rikuperohen ose që po u përfundon afati i imunizimit.

Kontrolli i vaksinimit ju ofron mundësinë të zbuloni lehtësisht nëse mbrojtja e fëmijës suaj përmes vaksinimit është aktualizuar.

Ja se si realizohet kontrolli i vaksinimit:
Jepini fëmijës suaj kartën e vaksinimit (ose një kopje të plotë)
më _____ në një zarf të mbyllur me vete në shkollë.
Ju lutemi, merreni datën nga shkresa origjinale në gjermanisht e Departamentit të Shëndetësisë.
Shkruani në të emrin e fëmijës suaj.
Bashkëngjisni edhe një zarf tjetër bosh, në të cilin të jetë shkruar gjithashtu emri i fëmijës suaj. (Ky zarf do të shërbejë për përgjigjen.)

Punonjësit e Departamentit të Shëndetësisë do të shqyrtojnë kartat e vaksinimit. Më pas fëmija juaj do të marrë kartën dhe fletën informuese në zarfin e përgatitur dhe të mbyllur.

Është e rëndësishme që të dini se: Shëndeti i fëmijës suaj është i rëndësishëm për ne. Me këtë veprim duam t'ju ndihmojmë duke aktualizuar mbrojtjen e fëmijës suaj përmes vaksinës. Nga data 01.01.2013, prindërit janë të detyruar të paraqesin librezat ekzistuese të vaksinimit gjatë seancave këshillimore shkollore për vaksinimet, nga Shërbimi Shëndetësor Publik sipas nenit 12 parag. 3 fjalia 5 i Ligjit për Shërbimin Shëndetësor (GDG).

Gjatë këtij procesi, në Departamentin e Shëndetësisë nuk do të regjistrohet **asnjë e dhënë personale** për fëmijën tuaj (shihni edhe shënimet për mbrojtjen e të dhënave).

Për këshillim të mëtejshëm dhe për kryerjen e vaksinave ende që nuk janë bërë ende, kontaktoni pediatri ose mjekun e familjes. Atje ofrohet gjithashtu kontrolli mjekësor parandalues (J1) për adoleshentët nga 12 deri 14 vjeç. Kjo rekomandohet dhe paguhet nga kompanitë e sigurimit shëndetësor.

Nëse keni pyetje, mos hezitoni të na kontaktoni. Ju falënderojmë paraprakisht për mbështetjen tuaj dhe ju urojmë juve dhe familjes suaj një vit shkollor të shëndetshëm.

Me respekt

Shënime për mbrojtjen e të dhënave: Në kuadër të shqyrtimit të librezës së vaksinimit në klasat e gjashta, nuk do të ruhet asnjë e dhënë personale nga Departamenti i Shëndetësisë. Për kthimin e librezës së vaksinimit do të shënohet emri mbi zarfin dhe fletën informuese që ndodhet brenda tij, lidhur me rezultatin personal të kontrollit të vaksinimit. Ai nuk do të ruhet. Të dhënat e kartës së vaksinimit lidhur me vaksinimet e bëra dokumentohen vetëm në mënyrë anonime për qëllime statistikore. Departamenti i Shëndetësisë dhe Zyra Vendore Bavareze për Shëndetin dhe për Sigurinë e Ushqimit (LGL) i përpunon këto të dhëna të mbledhura në mënyrë anonime për përlogaritjen vjetore të kuotave rajonale të vaksinimit në klasat e gjashta. Ato përfshihen në raportin shëndetësor të LGL-së dhe janë të disponueshme pa pagesë në www.lgl.bayern.de/impfreport.